

Konsulencë mbi kontrceptivët

Konsulencia mbi kontrceptivët duhet të ofrohet, nga ana e operatorëve të shërbimeve (Consultori familari, Spazio Giovani, Spazio Giovani adulti e Spazio Donne immigrate), brenda 14 ditëve dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e kërkesës.

Kjo konsulencë mund të ofrohet nga mamia ose gjinekologu/gia. Konsulencia mbi kontrceptivët nga ana e mamisë në shërbimet e këshilltoreve është gjithmonë falas.

Këshillimi nga ana e mjekut gjinekolog në këshilltore kryhet kundrejt një pagese (ticket) dhe është falas vetëm disa fasha moshash ose në disa kushte të veçanta.

Pas këshillimit mund të jepen falas (gjithmonë vetëm për disa fasha moshash ose ne disa kushte të veçanta) këto metoda kontrceptive: kontrceptivë hormonal (hormone që gëlltiten, ato më përthithje lëkure ose me rrugë vaginale), impiante nën lëkurë, mekanisma brenda mitral (IUD bakri me lëshim progesteroni), kontrceptivë urgjent (hormonal ose IUD bakri) dhe prezervativ femror dhe mashkullor.

Kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar falas këto shërbime:

Qytetarë (meshkuj e femra) me moshë nën 26 vjeç

- italian, qytetarë të bashkimit evropian dhe të huaj të rregjistruar në shërbimin shëndetsor (SSN) QË JANË REZIDENT (me vendqëndrim) DHE TË ASISTUAR NË RAJONIN E EMILIA ROMAGNA;

- kërkues azili apo që gëzojnë mbrojtjen (PSU)

- të huaj mbartës së kartës STP

Gra nga mosha 26-45 vjeç që gëzojnë “esenzione E02” (të papunësuar) ose E 99 (punonjëse të goditura nga

kriza ekonomike) në 24 muajt pas ndërprerjes vullnetare të shtatzanisë ose në 12 muajt mbas lindjes:

- italiane, qytetare të bashkimit evropian dhe të huaja të rregjistruara në shërbimin shëndetsor (SSN) QË JANË REZIDENTE (me vendqëndrim) DHE TË ASISTUARA NË RAJONIN E EMILIA ROMAGNA;

- kërkues azili apo që gëzojnë mbrojtjen (PSU)

Nëse dikush paraqitet në këshilltoren familjare me recetën e një gjinekologu privat, apo të një mjeku tjetër, nuk mund ti jepet kontrceptivi falas. Për dhënien e kontrceptivëve falas është kusht kryerja e konsulencës mjeksore në këshilltoret.

Për informacione të mëtejshme drejtohuni tek këshilltoret e zonës përkatëse (shiko vendet ku ofrohet shërbimi).

Asistencë dhe këshillim për të rinjtë

Të rejtat dhe të rinjtë mund të drejtohen personalisht (edhe pa praninë e prindërve) në çift apo në grup në Këshilltoren familjare, në hapsirën e dedikuar për to (Spazio giovani). Ktu i presin operatorë që ofrojnë informacione, konsulencë, mbështetje edukative mbi tematikat seksuale, të jetës emocionale dhe relacionale, të kontrceptivëve dhe parandalimeve. Operatorët janë profesionist posaçërisht të formuar.

Në faqen Spazio giovani do të gjeni informacione të mëtejshme.



(2)



Ndërmjetësim kulturor, informacione të dobishme për qytetarët e huaj.

Ndërmjetësimi kulturor ka si qëllim, nëpërmjet mediatorëve kulturor të kombësive të ndryshme dhe përkthyesve, të ndihmojë qytetarët e huaj në përdorimin e strukturave dhe të shërbimeve shëndetsore duke ofruar mbështetje në procesin e diagnozave dhe të mjekimeve. Në zona të ndryshme të territorit gjenden sportele aktive të ndërmjetësimit kulturor dhe gjatë gjithë harkut ditor është i gatshëm një shërbim kulturor, me thërritje, si për personat e shtruar (i aktivizuar nga struktura e shtrimit) si për pacientët e ambulatorëve (nën kërkesën e operatorëve)

Në shërbimin kulturor përfshihen, përveç përkthimit të dokumentave klinik edhe përkthime e përhapje të materialeve informuese, në rastet kur nevojitet, dedikuar të huajve.

Në strukturat shëndetsore të vendosura në bregdetin e Romagna-s është i disponueshëm një shërbim përkthimi. Qytetari i huaj mund ti drejtohet njëres prej strukturave fikse të Ndërmjetësimit kulturor për të pasur informacionet e duhura në lidhje me procesin mjeksor.

Në rast shtrimi në Spital, Ndërmjetësimi kulturor mund të aktivizohet direkt nga operatorët shëndetsorë, informacione të dobishme në italisht, arabisht, frëngjisht, kineze dhe anglisht

Asistencë për gratë emigrante dhe fëmijët e tyre

Gruaja emigrante, edhe pa leje qëndrimi mund ti drejtohet “Spazio”, vend i dedikuar grave emigrante, pranë Këshilltores familjare për asistencë personale dhe për fëmijët e saj. Në këtë strukturë grave u ofrohet asistencë për shtatzaninë, menopauzën, kontraktivët dhe sterilitetin nëpërmjet këshillimit të mamisë dhe vizitës së gjinekologut. Fëmijëve u ofrohen vizita pediatrike, bilance shëndetsorë, vaksinime, kontroll për tuberkulozin dhe sëmundjet ngjitëse. Në “Spazio” për gratë emigrante dhe fëmijët e tyre është e pranishme një ndërmjetëse kulturore për të ndihmuar në komunikim. Aty ku nuk është i aktivizuar shërbimi “Spazio” gratë e huaja mund ti drejtohen Këshilltoresve familjare ose Pediatrikëve të komunitetit.



Cfarë nevojitet?

Për personat pa leje qëndrimi është e nevojshme karta STP (i huaj i pranishëm përkohësisht)

Ku të drejtohem?

Këshilltores familjare dhe “Spazio” për gratë emigrante dhe fëmijët e tyre.

Asistencë për fëmijët endacakë dhe ekstrakomunitar

Këta fëmijë edhe pse nuk janë të regjistruar në Shërbimin shëndetsor asistohen gjithsesi nga ana e Usl nëpërmjet pediatrikëve të komunitetit e nga “Spazio” (vend) për gratë emigrante dhe fëmijët e tyre duke vlerësuar nevojat, duke kryer bilance shëndeti, vaksinime, kontrolle për sëmundjet infektuese.



Vizitë nga mamia dhe bashkëbisedim për shtatzaninë

Gruaja shtatzanë mund të paraqitet direkt tek mamia e këshilltores për të verifikuar falas shëndetin e fetusit, për të marrë informacione mbi barrën, mbi asistencën gjatë lindjes në spital apo në shtëpi, për të programuar kontrollet e parashikuara dhe vizitat specialiste.

Kjo vizitë bën pjesë në procedurën e lindjes (percorso nascita), e kordinuar nga ana e disa operatorëve dhe shërbimeve, që ndjekin gruan nga fillimi i shtatzanisë deri pas lindjes.

